



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0933

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE “KSF MAJOR” SH.A., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sherbimet e sigurimit fizik te objekteve komunale” me numër të prokurimit 624-25-6655-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA SUHAREKË”, më 05/11/2025, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e “KSF MAJOR” SH.A. me nr. 2025/0933, e datës 19/09/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sherbimet e sigurimit fizik te objekteve komunale”, me numër të prokurimit 624-25-6655-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – “KOMUNA SUHAREKË”.

2. Mbetet në fuqi B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “KOMUNA SUHAREKË” për aktivitetin e prokurimit “Sherbimet e sigurimit fizik te objekteve komunale”, me numër të prokurimit 624-25-6655-2-2-1.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 22.07.2025, “KOMUNA SUHAREKË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sherbimet e sigurimit fizik te objekteve komunale” me numër të prokurimit: 624-25-6655-2-2-1, ndërsa me datën 04.09.2025 Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues B58 për dhenie. OE “JAGUAR SECURITY SH.P.K.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 22,000.00€.

Me 09.09.2025, OE “KSF MAJOR” SH.A ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 10.09.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 19/09/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga “KSF MAJOR” SH.A me nr. 2025/0933 lidhur me aktivitetin “Sherbimet e sigurimit fizik te objekteve komunale” me numër të prokurimit: 624-25-6655-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim: ARSYETIM KSF MAJOR SH.A., Tirana 5, 20000, Prizren me adresë në Prizren lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Sherbimet e sigurimit fizik te objekteve komunale me Numër të prokurimit: 624-25-6655-2-2-1 Numër i brendshëm: 624-25-55-221 Kundër (NJOFfIM MBI VENDIM 1E AK), të datës: 04.09.2025 të publikuar në ueb—faqe; <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 09.09.2025 sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/1,-042 i ndryshuar dhç plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/1 .-092,

Pergjegje ndaj pretendimeve ankimore:

AK ka kërkuar sqarime dhe analizë financiare mbi mënyrën e realizimit të shërbimeve, duke u bazuar në Anekstn 1 të DT, konkretisht pët pagesën bruto të punëtorëve (> 350 €) dhe respektimin e Ligjit të Punës dhe Ligjit për Shërbime Private të Sigurisë, edhe pse kërkesa ishte e qarte per te ofruar Analiz financiare andaj ju keni deshtuar per te na ofruar kete analize dhe komisioni vleresuar ka vepruar ne menyre te drejte pasi qe nuk e keni vertetuar se pagesat e punëtorëve dhe respektimi i Ligjit të Punës do të mbulohen nga oferta e paraqitur.

Pas shqyrtimit te pretendimeve nga ana e juaj Autoriteti Kontraktues konstaton se Procedura është zhvilluar në pajtim me LPP, Rregulloren Nr. 001/2022 (e konsoliduar) dhe Udhëzuesin 002/2024, po ashtu nuk ka pasur eliminim të padrejtë apo shkelje tëkriterëve, andaj komisioni ka vepruar dhe ka zbatuar parimin e tenderit më të përgjegjshëm me çmimin më të ulët gjithashtu asnjë prej pretendimeve të parashtruata nga ana e juaj nuk mbështetet në bazë ligjore apo faktike.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “KSF MAJOR” SH.A janë parashtruar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues fillimisht përmes Komisionit për vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit gjatë procedurës së vlerësimit ekzaminimit dhe krahasimit të tenderit, si dhe ZPP- gjatë aprovimit te rekomandimit mbi eliminimin nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit dhe Refuzimit te Kërkesës për rishqyrtim (ne tekstin e mëtejme do ti referohemi Autoriteti Kontraktues) pretendojmë AK ka bërë shkelje te dispozitave të;

I. ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejshme do të i referohemi LPP-së) dhe atë konkretisht:

>Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

>Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

>Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi i tenderit dhe

>Neni 60 Kriteret për dhënie të kontratës,

Në vazhdim të kësaj ankese do të i argumentojmë pretendimet tona ankimore lidhur me shkeljet e dispozitave të;

1. Të dispozitave të LPP-se në RK.

> Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Pretendojmë se Autoriteti kontraktues me vendimin e vet që të shpërblej me kontratë tenderin e Operatorit të rekomanduar i cili ka ofertuar me vlerë totale të kontratës në shumë prej 19, 564 .80 euro, ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 6, paragrafin 1. Dhe paragrafi 2, të LPP-se në Republikën e Kosovës.

Në vijim po citoj dispozitat e nenit 6. paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji,

1.Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë qefondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

2.Fondetpublike dhe burimetpublike qëjanë ofruar ose qëjanë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Bazuar në Vendimin e AK-se për rezultatin e tenderit i cili ka propozuar për shpërblim të kontratës, tenderin e OE në vlerë prej; 19,564.80 € si dhe bazuar në tenderin e parashtruesit të kësaj ankese i cili ka ofertuar me çmim prej 17,648.40 €, shohim qartë se AK, e ka dëmtuar buxhetin e AK-se dhe taksapaguesve të Kosovës në vlerë prej 1,916.40 € dhe me këtë rast ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 6 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-se.

> Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e

Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Pretendojmë se Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me neni 56 , paragrafin 1.1 dhe paragrafi 1.2 të LPP-se në Republikën e Kosovës.

Në vijim po citoj dispozitat e nenit 56. paragrafi 1.1 dhe 1.2 të këtij ligji, Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:

1.1.së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve

sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

1.2.së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.

Bazuar ne Njoftimin për kontrate dhe ne Dosjen e tenderit shohim se Analiza financiare nuk është përcaktuar kriter për kualifikim dhe përzgjedhje te operatoreve ekonomik.

Marrë parasysh faktin që Autoriteti Kontraktues, është i obliguar qe tenderin t vlerësoj në pajtim me kriteret për kualifikim dhe përzgjedhje te OE te përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe ne dosje te tenderit si dhe Kriterin për dhënie te kontratës, si dhe bazuar ne Vendimin e AK-se për shpërblim te kontratës te cilin e ka propozuar me çmimin me të larte, pretendojmë se Autoriteti kontraktues ka dështuar në kualifikimin dhe përzgjedhjen e operatoreve ekonomik, konformë kushteve formale administrative të pjesëmarrjes në tender si dhe kriterit për dhënie te kontratës, të përcaktuara në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit dhe me këtë rast ka shkel nenin 56 të LPP-së.

> Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi,

Pretendojmë se Autoriteti kontraktues fillimisht përmes, Komisionit për vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit, dhe me vone përmes aprovimit te rekomandimit nga ana e , Zyrtarit Përgjegjës te prokurimit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e këtij në ligji në momentin kur ka vlerësuar se tenderi i operatorit ekonomik i cili është propozuar për shpërblim te kontratës i cili ka ofertuar me çmimin më të larte ne krahasim me parashtruesin e kësaj kërkesë ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59 te duke shkel dispozitat e LPP-se.

Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar ne kundërshtim me neni nenin 59 te LPP-se ne momentin kur ka marre vendim për eliminimin e OE: KSF MAJORSH.A, icilikadorëzuartendertepërgjegjshëm nekuptim te dispozitave te LPP-se, si dhe ne kuptim te Rregullores për Prokurimin Publik :

Ne vijim te kësaj ankese e do te argumentojmë pretendimet ankimore duke cituar dispozitat ligjore si dhe duke i argumentuar me dëshmitë e dorëzuara dokumentare; LPP ne nenin 59, paragrafi 4 përcakton;

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në Jjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si tëpërgjegjshëm nëse: (i) përmbanvetëm gabime osepaqartësi të cilatmund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat,kushtet,dhekërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Pretendimi i AK-se për eliminim.

Autoriteti Kontraktues në letrën standarde për tenderues të eliminuar ndër të tjera ka konstatuar se;

Ju jeni eliminuar me arsyetimin se;

[Ju jeni diskualifiikuar] [Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye : Komisioni vlerësues gjate vlerësimit te tenderit ne fjale ka konstatuar se ju nuk keni sjell sqarim te analizës financiare ne fjale me

date 27,08,2025, po ashtu ne baze te kalkulimit te çmimit te ofruar nuk i përmbush obligimet financiare qe kërkohen ,me Ligjin e punës dhe Ligjin për sigurime private te sigurisë:

Sqarim lidhur me këtë pretendimin;

AK ne njoftimin për kontrate dhe ne dosjen e tenderit ne FDT ne paragrafin 9.1 dhe 9.2 a te dosjes se tenderit ka kërkuar:

Kërkojmë nga Kompania që të bëjë sigurimin fizik në dy objekte-pozicione: i.Objekti i Komunës, sigurimifizik të behet për 182 ore nën muaj, (118 ore) për ditët te punës, nga ora 16:00 deri ne ora 08:00 ,si dhe vikendeue (64 ore), nga ora 08:00 deri 08:00 24 ore.

2.Objekti teparku i Qytetit(salla e kuvendit), sigurimifizik të bëhetpër 544 ore në muaj, (352 ore) për ditëpune, nga ora 16:00 deri në ora 08:00, si dhe vikendeve (192), nga ora 08:00 deri 08:00 24ore.

Paga bruto mujore për një puriëtor nga Ofruesi i shërbimeve kërkohet të jetë së paku 350.00€ për një muaj. Po ashtu kërkohet të respektohet Ligji i punës dhe rregullat e aplikueshme lidhur me orët e punës për një muaj.

Ofruesi i Shërbimeve gjate realizimit te kontratës do te respektoj Ligjin e Punës nëfuqi si dhe Ligjin për Shërbime Private të Sigurisë 04/L-004, të Republikës së Kosovës.

Autoriteti Kontraktues gjate realizimit te kontratës gëzon te drejtën qe nëse vjen deri te hapja e ndonjë Qendre te re, te kërkoj nga Ofruesi i Shërbimeve qe shërbimet e sigurimit ti kryej edhe ne qendrat e hapura sipas kushteve te kontratës. Çmimi ipagesës për këto qendra do te jete çmimi për njësi i orës se shërbimeve sipas kontratës. Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues gëzon te drejtën e kërkesës nga Kryesi i shërbimeve për ndërprerjen e kryerjes se shërbimeve te sigurimit ne rast te mbylljes se ndonjëres nga Qendrat qe janëpjese e specifikacionit teknik te kësaj dosje te tenderit.

Pretendojmë se te gjitha këto kërkesa qe kane qen te përcaktuara ne Njoftimin për kontrate dhe ne dosjen e tenderit ne baze te cilave është dashur te vlerësohet tenderi: K.S.F” Major” Sh.a, ka ofruar dëshmi dokumentare ne pajtim me kërkesat e AK duke i ofruar dëshmi dokumentare se nëse shpallet fitues i kontratës do te i përmbahet Ligjit te punës dhe Ligjit për Shërbimet Private te Sigurisë.

Nuk qëndron asnjëri prej pretendimeve për eliminimin e AK-se nga aktiviteti i mëtejshëm i prokurimit

Parashtruesi i kërkesës ka gjate dorëzimit te tenderit ka nënshkruar m Deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike duke garantuar se te gjitha te drejtat te cilat i takojnë punonjësve do te i respektoj si dhe ka marre përgjegjësinë se ne rast te mos realizimit do te i nënshkruhet sanksioneve te parapara me Ligje te punës nga ane e organeve kompetentefInspektoratit te Punës) dhe organeve tjera kompetente shtetërore KSF MAJOR SH.A edhe tani ne këtë ankesë ju garanton se; ofrimi i shërbimeve do te jete plotësisht ne përputhje me kërkesat epërcaktuara ne aneksin 1 te dosjes se tenderit ku është dëshmuar me plotësimin e Një Deklarate (te nënshkruar dhe vulosur) origjinale ne oferte nga ofertuesi.

Edhe si kur te ekzistonin këto pretendime, AK gjate procedurës se vlerësimit te tenderit ka qen i obliguar qe te veproj ne pajtim me nenin 59.2 qe ndërlidhet me nenin 72 te LPP- se i cili përcakton qarte mesa vijon;

“Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohej ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ojhohen nga një tenderues”

Autoriteti kontraktues ka qen i obliguar që gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit të bëjë analizë e tregut në Kosovë e cila përkufizohet si proces që synon përpunimin e nevojave specifike që dalin nga analiza e nevojave dhe përcaktimin e metodës më të përshtatshme të blerjes për prokurimin përkatës.

Zakonisht përfshin mbledhjen, analizimin dhe interpretimin e informacionit rreth mallrave/shërbimeve/punëve për tu prokuruar, siç përcaktohet në analizën e nevojave.

Rezultatet që vijnë nga analiza e nevojave krahasohen me ofertën e tregut në mënyrë që të përputhen nevojat e tilla me atë që tregu është në gjendje të ofrojë në të vërtetë për përcaktimin e elementeve dhe karakteristikave thelbësore të prokurimit që duhet të kryhet.

Një analizë e përshtatshme e tregut duhet të mbështesë Autoritetet Kontraktuese në përcaktimin e llojit të procedurës dhe të lehtësojë aftësinë e tyre për të zhvilluar specifikimet e cilësisë, për të rritur kapacitetin për të negociuar me operatorët ekonomik më të përshtatshëm dhe për të ekzekutuar një kontratë që sjell rezultate të suksesshme të performancës KRPP në ueb faqen e saj ka publikuar Manualin për Specifikime teknike për Furnizime dhe Shërbime të zakonshme në piken 6 - Sigurimi i objekteve -Fushëveprimi (në faqen 33) ka përcaktuar qarte se;

Në rast se AK vendos që të përcaktoj pagën minimale, AK duhet të vendos këtë kërkesë tek kapaciteti teknik dhe profesional

Kërkesa:

Paga bruto mujore për një punëtor nga Ofruesi i shërbimeve kërkohej tëjetë sëpaku bruto xx (te përcaktohet nga AK) për një muaj, për orarinjavor prej 40 orëve.

Dëshmia:

Dëklaratë e nënshkruar nga OEpjesëmarrës se punëtorëve do të uapaguajpagën minimale sëpaku bruto xx (te përcaktohet nga AK) Euros, për orarinjavorprej 40 orëve.

Shënim: në këto raste, në mënyrë që të iu shmangemi çmimeve abnormale dhe çmimeve manipulative, AK mund tëpërcaktoj kërkesën si në vijim:

Kërkesa:

Ofertuesi së bashku me ofertë duhet tëprezantojë një analizëfinanciarëpërpagën bazë xx (te përcaktohet nga AK) bruto tëpasqyruara më tëgjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212. OE duhet tëparaqesë analizëfinanciare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimipërfundimtar e ku kjo analizë duhet tëpërfshijë sëpaku:

Pagat bazë Bruto xx (te përcaktohet nga AK) përpunëtorë, Pagesat shtesëpër ndërrimet e natës dhefestatshtetërore, Pushimet vjetore,Trustipensional, Fitimi i OE, TVSH-ja, Totali i ofertës

Dëshmia:

Analiza Financiare

Bazuar ne Njoftimin për kontratë dhe ne Dosjen e tenderit (Aneksi 1 -Specifikimet e detyrueshme teknike) te publikuar ne Ueb faqen e KRPP-se nga Autoriteti kontraktues shohim qarte se Autoriteti kontraktues ne FDT nuk ka vepruar ne baze te Manualit për specifikime teknike i cili ne faqen e fundit përmban tekstin ;

Paga bruto mujore për një punëtor nga Ofrucsi i shërbimeve kërkohet të jetë së paku 350.00€ për një muaj. Po ashtu kerkohet të rcspektohet Ligji i punës dhe rregullat e aplikushme lidhur me orët e punës për një muaj.

Ndërkaq Manuali përcakton qe Autoriteti kontraktues është i obliguar qe kur kërkon qe paga bruto e punëtorëve te jete 350 euro është dashur përveç “Deklaratës së nënshkruar nga OE pjesëmarrës se punëtorëve do të ua paguaj pagën minimale së paku bruto xx (te përcaktohet nga AK) Euros, për orarin javor prej 40 orëve” te kërkoj edhe Kërkesën;

Ofertuesi së bashku me ofertë duhet të prezantojë një analizë financiare për pagën bazë xx (te përcaktohet nga AK) bruto të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212. OE duhet të paraqesë analize financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar e ku kjo analizë duhet të përfshijë së paku: Pagat bazë Bruto xx (te përcaktohet nga AK) për punëtorë, Pagesat shtesë për ndërrimet e natës dhe festat shtetërore, Pushimet vjetore, Trusti pensional, Fitimi i OE, TVSH-ja, Totali i ofertës

Dëshmia:

Analiza Financiare

Bazuar ne dokumentet e tenderit si dhe Manualin e Specifikimeve Teknike, shohim qarte se AK ka kërkuar vetëm Deklaratën e nënshkruar nga OE pjesëmarrës se punëtorëve do të ua paguaj pagën minimale si dhe bazuar ne nenin 40.12 te Rregullores për Prokurimin Publik e cila përcakton;

“40.12 Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet ngaprocedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit”

Autoriteti kontraktues nuk ka te drejte te diskualifikoj një operator ekonomik për shkak te ndonjë kërkesë e cila nuk është kërkuar ne Njoftimin për kontratë dhe ne dosje te tenderit.

Bazuar ne faktet e lartshënuara pretendojmë se ky pretendim nuk qëndron sepse OE; K.S.F “Major” SH.A ka ofruar dëshmi dokumentare komfor kërkesës se AK-se te përcaktuara Aneksin 1 te dosjes se tenderit.

Duke pasur parasysh faktet e lartshënuara pretendojmë se AK gjate zhvillimit te procedurës se vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit te tenderit ka bere shkelje te nenit 59 te LPP-se.

> Neni 60 Kriteret për dhënie kontratës

Pretendojmë se AK përmes Komisionit për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të shpërblyer me kontrate një OE i cili ne është rekomanduar për shpërblym te kontratës dhe ka ofruar çmimin me te larte, ne krahasim me çmimin e ofruar nga parashtruesi i kërkesës

për rishqyrtim i cili ka ofruar çmimin me të ulte në vlerë prej 17, 648.40 €, dhe është eliminuar, ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 60 të LPP-se, duke mos respektuar Kriterin për dhënie të kontratës i cili ka qenë i përcaktuar në Njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit; Çmimin më të ultë, i tenderit të përgjegjshëm.

Citoj dispozitën e nenit 60 të LPP-se;

1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar:

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Duke pasur parasysh faktet e lartshënuara si dhe dispozitat e nenit 60 të LPP-se pretendojmë se AK ka bërë shkelje të dispozitave të këtij neni me rastin e marrjes së Vendimit për dhënie të kontratës për OE i cili për nga çmimi është më të lartë, pra AK nuk ka respektuar Kriterin për dhënie të kontratës.

Duke u referuar të pretendimet si më sipër Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Shkeljet e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejshëm do të i referohemi LPP-së) dhe - Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin Publik me plotësim ndryshimet e vitit 2024-NI'001/24. Duke pasur parasysh këto fakte i Panelit të OSHP që pas administrimit të provave dhe fakteve që të marrë këtë: VENDIM Te aprovoj, Aprovoj ankesën si të bazuar të parashtruar nga OE; K.S.F Major SH.A”, Te ANULOJ, Njoftimin mbi Vendimin e AK-se të datës 04.09.2025 mbi rezultatin e tenderit (B58) ku është propozuar për shpërblyerje të kontratës OE: “Jaguar Security “ sh.p.k me vlerë totale të kontratës prej 19. 564.80 euro. Te KTHEJ TENDERIN NE RIVLERESIM, dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me kriteret për dhënie kontratës dhe kriteret e përzgjedhjes të cilat janë të përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në FDT të dosjes së tenderit në pajtim me LPP-në dhe Udhëzuesin nr.002/2024 për Plotësim Ndryshimin për Prokurimin Publik Manualin për specifikime teknike.

Duke u mbështetur në neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues me datë 26.09.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0933/25, ndërsa me datë 07.10.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0933 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale AK nuk ka dhënë përgjigje me raportin e ekspertizës ndërsa OE nuk ka dhënë përgjigje rreth raportit të ekspertit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësit dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “KSF MAJOR” SH.A ekspertit shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0933 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi 1 – Shkelja e Nenit 6 të LPP-së (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti)

* Pretendimi i OE Ankues:

Autoriteti Kontraktues (AK) ka shpërblyer një ofertë më të lartë (19,564.80€) duke refuzuar ofertën e tyre më të ulët (17,648.40€), dhe për këtë arsye ka dëmtuar interesin publik dhe ka shkelur parimet e ekonomicitetit dhe efikasitetit, siç parashihen në nenin 6 të LPP-së.

* Vlerësimi i Ekspertit:

Dokumentet e tenderit kanë përcaktuar se kriteri për dhënien e kontratës është “oferta më e ulët nga operatorët e përgjegjshëm”, në përputhje me nenin 60.1.1 të LPP-së. OE ankues është eliminuar nga gara për shkak të mosdorëzimit të analizës financiare të kërkuar nga AK, si përgjigje ndaj sqarimit të bazuar në Aneksin 1 të specifikimeve teknike.

Si pasojë, oferta e OE-së nuk është konsideruar e përgjegjshme dhe nuk ka mundur të merret në konsideratë për dhënie të kontratës. Për këtë arsye, pretendimi për shkelje të ekonomicitetit dhe efikasitetit është i pabazuar.

Pretendimi 2 – Shkelja e Nenit 56 të LPP-së (Përdorimi i kriterëve jo të parapara në DT)

* Pretendimi i OE Ankues:

OE ankues pretendon se AK ka përdorur një kriter shtesë (analiza financiare) që nuk ishte parashikuar në dosjen e tenderit, duke shkelur nenin 56 të LPP-së dhe parimin e transparencës.

* Vlerësimi i Ekspertit

Në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit, AK ka përcaktuar qartë se:

“Paga bruto mujore për një punëtor nga Ofruesi i Shërbimeve kërkohet të jetë së paku 350.00 euro për një muaj. Po ashtu kërkohet të respektohet Ligji i Punës dhe rregullat e aplikueshme lidhur me orët e punës për një muaj.”

Po ashtu është kërkuar respektimi i Ligjit për Shërbime Private të Sigurisë 04/L-004.

Edhe pse nuk ishte e shprehur drejtpërdrejt kërkesa për "analizë financiare", përmbajtja e Aneksit 1 dhe obligimet ligjore të përmendura kanë shërbyer si bazë legjitime për AK që të kërkojë sqarime shtesë, në përputhje me nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Kërkesa për analizë financiare nuk ka përbërë ndryshim material të tenderit, por ka pasur si qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së çmimit të ofruar me obligimet ligjore dhe kërkesat minimale të përcaktuara në tender.

Prandaj, pretendimi për shkelje të nenit 56 është i pabazuar, pasi AK ka vepruar në përputhje me ligjin dhe brenda kompetencave të tij për të kërkuar sqarime.

Pretendimi 3 – Shkelja e Nenit 59 dhe nenit 40.12 të Rregullores (Eliminimi i OE-së)

* Pretendimi i OE Ankues:

OE ankues pretendon se është eliminuar në mënyrë të padrejtë për mungesë të analizës financiare, duke u thirrur në nenin 59 të LPP-së dhe në nenin 40.12 të Rregullores për Prokurim Publik, duke theksuar se një kërkesë e tillë nuk ishte e specifikuar qartë në dosjen e tenderit.

* Vlerësimi i Ekspertit:

Pas shqyrtimit të dokumenteve të tenderit, konstatohet se në Aneksin 1 – Specifikimet teknike, është kërkuar në mënyrë eksplicite që paga bruto mujore të jetë së paku 350.00 euro, si dhe të respektohen Ligji i Punës dhe Ligji për Shërbime Private të Sigurisë.

Kjo kërkesë për pagë minimale në përputhje me ligjet në fuqi, ndonëse nuk përmend analizën financiare si dokument specifik, ka qenë bazë ligjore që e justifikon kërkesën e AK për sqarim të ofertës.

Në përputhje me nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, AK ka të drejtë të kërkojë sqarime për çdo aspekt të ofertës që ka nevojë për vlerësim të mëtejshëm. Kërkesa për analizë financiare është bërë me qëllim të verifikimit të realizueshmërisë së ofertës dhe pajtueshmërisë me kushtet ligjore.

OE ankues nuk e ka dorëzuar analizën e kërkuar brenda afatit të përcaktuar, duke rezultuar në moskualifikim të ofertës së tij si e papërgjegjshme, në përputhje me nenin 59 të LPP-së.

* Konkluzion i Ekspertit:

Pretendimi është i pabazuar. Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me nenet 59 dhe 72 të LPP-së. Kërkesa për sqarim nuk ka përbërë ndryshim të kriterëve, por ka pasur për bazë dispozitat e dokumentacionit të tenderit dhe ligjet përkatëse.

Pretendimi 4 – Shkelja e Nenit 60 të LPP-së (Dhënia e kontratës ofertës më të shtrenjtë)

* Pretendimi i OE Ankues:

OE ankues pretendon se është shkelur neni 60 i LPP-së, sepse AK ka dhënë kontratën një operatori me çmim më të lartë, edhe pse OE ankues kishte ofertuar çmimin më të ulët.

* Vlerësimi i Ekspertit:

Sipas dokumenteve të tenderit dhe nenit 60.1.1 të LPP-së, kontrata duhet t'i jepet ofertës më të ulët ndërmjet operatorëve ekonomikë të përgjegjshëm.

Në këtë rast, oferta e OE ankues është vlerësuar si e papërgjegjshme, për shkak të mosdorëzimit të analizës financiare që justifikon përputhshmërinë me pagën minimale dhe ligjet përkatëse, siç kërkohej në Aneksin 1 të DT-së.

Si rrjedhojë, AK ka vepruar në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me ligjin kur ka shpërblyer ofertën më të ulët ndërmjet operatorëve të përgjegjshëm.

* Konkluzion i Ekspertit:

Pretendimi është i pabazuar, pasi dhënia e kontratës është bërë sipas kritereve të përcaktuara dhe në përputhje me LPP-në. OE ankues nuk ka pasur ofertë të përgjegjshme dhe për këtë arsye nuk ka mundur të jetë përfitues, pavarësisht çmimit më të ulët.

Përfundim i përgjithshëm:

Pas shqyrtimit të gjitha pretendimeve, konstatohet se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme dhe se Paneli ja fal besimin ekspertit shqyrtues dhe konsideron se me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi vendimin e AK-së të aktivitetit të prokurimit të Autoritetit Kontraktues – “KOMUNA SUHAREKË” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sherbimet e sigurimit fizik të objekteve komunale” me nr. të prokurimit: 624-25-6655-2-2-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive

të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - KSF MAJOR SH.A.**
- Arkivës së OSHP-së: